

## Profesori maqedonas studion kërpudhat e Shqipërisë



**Shkup, 25 qershor-** Ekipi i udhëhequr nga Profesor Mitko Karadelev nga Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore në Shkup tashmë është duke punuar një kohë në projektin "Kërpudhat e Shqipërisë: Verifikimi (përcaktimi) i listës së kërpudhave dhe Listës së kuqe prelinare (paraprake) si dhe propozimi i regjioneve të rëndësishme të kërpudhave në Shqipëri" (1 prill 2013 - 30 shtator 2014), mbështetur nga Fondacioni "Raforid të Anglisë".

Ekipi mbështetet në përvojën e tij në lidhje me Listën e Kuqe, të fituar në një projekt të ngjashëm për ruajtjen e kërpudhave e zbatuar në Maqedoni. Deri më tani, kërpudhat e Shqipërisë ishin të

studiuar shumë pak dhe kishte informacionezyrtare mjaft të rralla rreth tyre. Vendi nuk disponon me përshkrim të kërpudhave as me listë të kuqe.

Mungon Legjislacioni për mbrojtjen e kërpudhave edhe pse eksportohen sasi të mëdha të kërpudhave. Duke iu falënderuar shumëllojshmërisë së klimës, tipeve vegjetative dhe substrateve, pritej një diversitet i lartë i kërpudhave, kurse me projektin u konfirmuan këto pritje.

Janë marrë të dhëna për rreth 600 lloje të kërpudhave dhe më pas u formua një bazë e të dhënave për të gjitha llojet e kërpudhave të identifikuar në Shqipëri, që është në dispozicion online (<http://macfunji.webs.com/fungjialbanici.htm>).

Projekti përfshin edhe ngritjen e vetëdijes publike përmes ligjëratave përpara banorëve vendor si dhe zyrtarëve relevante shqiptare, mbi këtë çështje dhe shpërndarjen e materialeve promovuese.

Studimet e shumta në terren janë kryer në më shumë se 30 vende në pjesë të ndryshme të vendit, kryesisht në parqet nacionale: Valbona, Hotovës, Prespa, Llogara, Dajti, Shebenik-Jabllanicë, Korab-Koritnik dhe Tomor.

Lista e parë paraprake e kërpudhave, përgatitur në përputhje me kriteret e IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës-UNRN), është gati dhe u paraqit në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare e Ekosistemeve në Tiranë ICE-2014 (23-26 Maj-2014).

Do të propozohen edhe fusha të rëndësishme të kërpudhave (FRK), në varësi nga prania e specieve të rralla dhe të rrezikuara, pasuria dhe rëndësia mikologjike e habitateve.

Lista do të jetë bazë për përpilimin e njëListe të Kuqe zyrtare të kërpudhave dhe përgatitjen e legjislacionit për mbrojtjen e kërpudhave. Aktivitetet e këtij projekti mund të futen më tej në Strategjinë Kombëtare shqiptare dhe PlanitAksionar për Biodiversitetin.

Ekzemplar reprezentues të kërpudhave do t'i dhurohen Muzeut Shkencor-Natyrorë Shqipëri apo ndonjë institucioni të interesuar me qëllimtkrijimit të një Koleksioni Kombëtar të Kërpudhave të Shqipërisë.

© ZHURNAL.mk

Publikuar më 25.06.2014 në 10:56 nga R.ZH.

2,528 herë i lexuar



Të gjitha të drejtat e përmbajtjes në këtë portal janë të rezervuara.

Ndalohet ribotimi i përmbajtjes (lajmeve dhe të gjitha shkrimeve të tjera) pa lejen me shkrim të portalit « Zhurnal ». Çdo përdorues publik i përmbajtjes sonë pa autorizimin e posaçëm nga « Zhurnal » rrezikon të ballafaqohet me ligjin.

568 online

2010 - 2015 © ZHURNAL - Agjenci e lajmeve



**"Dnevnik":BDI-në do të themelohet Parlament shqiptar në Maqedoni?! BDI për Zhurnal: Nuk është**



**Menduh Jashari zgjidhet kryetar i PPD-së dega në Komunë të Likovës**



**Diaspora kritikon partitë shqiptare nga viti 2002 që iu "gjunjuzuan" Gruevskit dhe Cërvenkovskit**



**U arrestuan tri persona nga aksioni i sotëm policor në Lagjen e trimave**



**Thaçi-Feith: Marrëveshja e Përzihos të implementohet**



**Maleski: Ambasadorët, Gruevskit po i tregojnë frerët**



**RDK uron Kosovën për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asociimit me Bashkimin**



**Spitali i qytetit: Mos i nxini mjekët, pak prej tyre janë të na nërnieishëm**

European



**Selmani: Për cilin popull Gruevski e ka fjalën, pasi që vetëm 26 % kanë votuar për të?**



**Të Bashkuar për Maqedoninë në një takim pune me Zaevin**